



Спроведувач на активноста:
Прва детска амбасада во светот "Мефташи"



ГРАЃАНСКА
ПЛАТФОРМА
НА МАКЕДОНИЈА


ДЕЛ ОД ПРОГРАМАТА НА ГРАЃАНСКА
ПЛАТФОРМА НА МАКЕДОНИЈА,
НО НЕ ГИ ОДРАЗУВА ЗАДОЛЖИТЕЛНО
СТАВОВИТЕ НА СИТЕ ЧЛЕНКИ НА ГПП



Support to a National Civil Society Forum Platform
An EU funded project, managed by the European Agency for Reconstruction
Поддршка на национална форум платформа на граѓанското општество
Проект финансиран од ЕУ, а реализиран од Европската агенција за реконструкција



DORACAK
PËR
VULLNETARË



"This publication has been developed with the assistance of the EU funded Project "Support to national Civil Society Platform/Forum, 03Mac01/112". However, its content, including the references to the denomination of the partner country, does not represent the official position of the EU. All institutions of the EU refer to the country exclusively under the provisional denomination 'the former Yugoslav Republic of Macedonia', in line with the UNSC Resolutions 817/93 and 845/93. "

Ky publikim është realizuar në kuadër të projektit „Përkrahje të forumit kombëtar/ të platforma e shoqërisë civile, 03MAC01/01/112“, me mbështetje financiare nga Unioni Evropian (UE). Përmbajtja e publikimit, duke përfshirë edhe emrin e shtetit-partner, nuk e pasqyron qëndrimin zyrtar të UE-së. Të gjitha institucionet e UE- së e përdorin referencën „Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë“, në pajtim me rezolutën e Këshillit të sigurimit të Kombeve të Bashkuara 817/93 dhe 845.93.

"Kërkoni

mënyrë

për

krijimin

e

vlerave

të

reja

në

themelin

e

secilës

përvojë"

(Suzan Xheferson)



A JE NJERI I CILI DËSHIRON NDRYSHIME?

A DO TA KISHE NDRYSHUAR MJEDISIN OSE A KE IDE TË NDRYSHME?

DËSHIRON TË JESH VULLNETAR, POR NUK DI SI?

KËTO INFORMATA JANË PJESË E SFIDËS SË QUAJTUR PUNË VULLNETARE

ÇKA ËSHTË PUNA VULLNETARE

lat. *volo, velle, volui* - të dëshirohet diçka;
voluntas, ātis, f. - dëshirë, vullnet, qëllim, vullnet i lirë;

Puna vullnetare është aktivitet i njerëzve të cilët kanë dëshirë ta investojnë kohën e tyre të lirë, forcën punuese, diturinë dhe punën, pa kompensim në të holla, për mirëqenien e ndonjë individi, grupi, bashkësisë ose mjedisit jetësor.

"Nga puna vullnetare nuk mund të jetohet, por kjo e begaton jetën në mënyrë të veçantë".
(Avniu, 30 vjet)

"Me punën vullnetare krijohet një filozofi e re e jetës".
(Milica, 57vjet)

Zhvilloje përgjegjësinë tënde shoqërore.

Puna vullnetare kontribuon për ndryshimet demokratike në secilën shoqëri. Përmes kësaj pune krijohet ndjenja e përgjegjësisë ndaj bashkësisë, dhe vazhdimisht përcaktohet dhe konfirmohet rëndësia e vlerave si: solidariteti, bashkësia, barabarësia, mosdhuna, kujdesi për mjedisin jetësor, etj. Duke u përfshirë si vullnetarë në nisma të ndryshme qytetare, qytetarët marrin pjesë në formësimin e shoqërisë, dhe duke punuar për të tjerët - ne njëherazi punojmë edhe për veten.

Puna vullnetare është pjesë e secilit civilizim ose shoqërim. Ajo mund të paraqitet në disa forma, duke filluar nga forma tradicionale e ndihmës së ndonjë personi në nevojë, deri tek veprimi i organizuar në rajonet e krizës.

Korniza shoqërore në të cilën realizohet puna vullnetare në ditën e sotme, dallohet nga format fillestare të punës vullnetare, për shkak se tani i ndihmojmë njerëzve të cilët nuk i njohim, ose punojmë për zgjidhjen e problemeve të cilat e prekin bashkësinë e gjerë.

Kur përmendet puna vullnetare, më së shpeshti mendojmë në pjesëmarrjen në veprimtari bamirëse, si ndihma në kuzhinat popullore, ose mbledhja e veshjes për të varfrit. Por, puna vullnetare mund të jetë shumë më tepër se kaq.

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.



Përmes punës vullnetare, sot mund të punohet për diçka në të cilën besojmë, të merret përgjegjësia dhe të bëhet përpjekje për ndryshime të drejtpërdrejta. Fushëveprimi i aktiviteteve në të cilat mund të marrësh pjesë si vullnetar/e është tepër i gjerë, duke filluar nga ndihma e të tjerëve, deri tek parashtrimi i pyetjeve dhe çështjeve për të cilat mendon se duhet të ndryshohen ose zgjidhen. Puna vullnetare është e lidhur ngushtë me sistemin e vlerave të secilit njeri.



Puna vullnetare më së shpeshti lidhet drejtpërdrejtë me shfaqjen e dashurisë për të tjerët, ose humanitetit. Por, kohëve të fundit ekzistojnë çdoherë e më tepër aktivitete për mbrojtjen e mjedisit jetësor (bimëve, kafshëve, ujit, ajrit, etj), të cilat lidhen me humanitetin në mënyrë tërthore, janë të dobishme për njerëzit në mjedisin e afërt, por edhe të gjerë, si dhe për gjeneratat e ardhshme.



Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

"Volunteerism is the willingness of people to work on behalf of others without the expectation of pay or other tangible gain."
(<http://en.wikipedia.org/wiki/Volunteerism>)

"Any activity which involves spending time, unpaid, doing something which aims to benefit someone (individuals or groups) other than or in addition to, close relatives, or to benefit the environment"
Institute for Volunteering Research
(<http://www.ivr.or>)

"Puna vullnetare është dëshira e njerëzve të punojnë për mirëqenien e të tjerëve, duke mos pritur asnjë kompensim në të holla, ose ndonjë përfitim tjetër të prekshëm".
(<http://en.wikipedia.org/wiki/Volunteerism>)

"Secili aktivitet i cili e përfshin kalimin e kohës, pa kompensim në të holla, me qëllim që të ndihmohet në mirëqenien e dikujt tjetër (individ ose grup), ndonjë kushëriri të afërt, ose mirëqenien e mjedisit jetësor". Institute for Volunteering Research (<http://www.ivr.org.uk/nationalsurvey.htm>)

Shoqërohu me të tjerët me ide të ngjashme për përmirësimin e kushteve tuaja, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve për jetesë shoqërore

ÇKA NUK ËSHTË PUNA VULLNETARE ?

Një prej cilësive kryesore të punës vullnetare, është që për këtë punë nuk fitohet asnjë kompensim në të holla. Por, kjo nuk do të thotë se të gjitha punët për të cilat nuk fitohet kompensim në të holla mund të konsiderohen si punë vullnetare. Për shembull, puna si praktikant, në projekte të bursave, praksa e papaguar e cilitdo lloj, shërbimi ushtarak civil, ndihma në sektorin afarist etj, nuk janë punë vullnetare.

Puna vullnetare i nënkupton vetëm aktivitetet dhe veprimet të cilat bëhen vetëm me vullnet dhe zgjidhje të lirë, qëllimi përfundimtar i të cilave është mirëqenia e të tjerëve ose shoqërisë.



Vini re! Këto janë aktivitete në të cilat vullnetarët nuk shfrytëzohen si forcë e punës pa pagesë, me qëllim të krijimit të përfitimeve!

Mund të japësh kontribut në krijimin e vizionit të posaçëm për botën dhe mjedisin rrethues

ÇKA ËSHTË E NEVOJSHME PËR PUNËN VULLNETARE

- INTERESI

Dëshira e individit/grupit për punë vullnetare. Vullnetari/ja duhet qartë ta shprehë dëshirën për punë vullnetare në fushat në të cilat ka njohuri dhe aftësi. Në rast se shprehet dëshira për punë vullnetare në ndonjë fushë për të cilën individit nuk ka dituri dhe aftësi, atëherë nevojitet dëshira për pjesëmarrje në procesin e edukimit dhe aftësimit.

- NEVOJA

Ndonjë individ ose grup në bashkësi ka nevojë për ndihmë. Pranuesi i ndihmës duhet ta kërkojë dhe të pajtohet me ndihmën e ofruar. Nevoja për angazhimin e vullnetarëve përcaktohet nga organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, ose ndonjë grup i qytetarëve të cilët e kanë vlerësuar nevojën si reale. Vullnetarët mund të angazhohen edhe sipas kërkesës së individëve, ose ndonjë grupi të qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmë.

- ÇILTËRSIA

Organizatat ose institucionet të cilat e mundësojnë punën vullnetare duhet të jenë të çiltër - ndaj individëve të cilët dëshirojnë të kryejnë punë vullnetare, dhe ndaj institucioneve/ organizatave të cilat kanë nevojë për vullnetarë. Për qëllime të kontaktit të vazhdueshëm me grupin në shënjestër, organizatat e qytetarëve janë më të volitshme për ndërmje tësim, motivim dhe promovim të punës vullnetare.

- VIZIONI

Për shkak të ndryshimeve të shpejta në zhvillimet socio-ekonomike, shëndetësore dhe ekologjike, është e rëndësishme të ketë vazhdimësi në përkryerjen dhe përmirësimin e mënyrës për vlerësimin e nevojave për momentin, dhe kohën e mobilizimit të vullnetarëve, ose përfshirjen ndaj institucionit/ organizatës në fushën ku është shprehur nevoja, gjegjësisht interesi.



KUSH MUND TË JETË VULLNETAR/E ?



Vullnetarët janë njerëzit të cilët pavarësisht nga puna e tyre profesionale, ose ndonjë përcaktim tjetër, kanë zgjedhur me ndërgjegje dhe vullnet të lirë që një pjesë të kohës së lirë, diturisë, përvojës dhe energjisë ta ndajnë me të tjerët, dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë për përmirësimin e jetës së përbashkët.

Në të shumtën e rasteve, për punën vullnetare nuk nevojitet asnjë nivel i posaçëm i arsimit. *Kushdo* që ka vullnet të mirë mund të jetë vullnetar/e. Fusha e aktiviteteve në të cilat mund të realizohet puna vullnetare është aq e madhe, sa që secili do ta gjejë veten në ndonjë pjesë, ku do ta realizojë dëshirën të cilën e ka.

Vullnetarët dhe vullnetaret më së shpeshti zgjedhin t'i punojnë punët të cilat i njohin mirë, dhe të cilat mund t'i kryejnë vetë. Në rastet kur vullnetarët nuk janë të edukuar në masën e nevojshme për ndonjë punë konkrete, para fillimit të punës ju mundësohet edukimi plotësues, kurse gjatë vetë punës ata udhëzohen nga profesionistët të cilët i mbikëqyrin, përcjellin dhe përkrahin në realizimin e detyrave.

As moshë nuk ka ndonjë rol kufizues në punën vullnetar(ë)e.

Të gjithë njerëzit mund të kryejnë punë vullnetare, pa dallim të moshës. Ekzistojnë vullnetarë fëmijë, të rinj, të rritur, më të moshuar, pensionistë, kurse në botë ekzistojnë edhe programe vullnetare ku përfshihet mbarë familja. Për të gjithë vullnetarët e mitur nevojitet pëlqimi i prindit/ kujdestarit.

Vini re! Fëmijët nën moshën 15 vjeçare nuk mund të angazhohen për aktivitete më të rënda fizike.

Në rast se ende nuk je i/e sigurt dhe mendon që nuk ke shkathtësi të posaçme dhe specifike të cilat mund t'i ofrosh, përkujtohu edhe në këtë: Për shumë punë vullnetare nevojiten gjëra të thjeshta - të jeni në disponueshmëri për dikë tjetër, ndoshta thjeshtë vetëm për bisedë, kujdes, ose vetëm si një palë tjetër e duarve për të kryer diçka.

*"Puna vullnetare mund të bëhet të gëzuar në mënyrë të posaçme".
(Zymreta, 45 vjet)*

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.

PSE KRYEJMË PUNË VULLNETARE DHE VULLNETARET?

Vullnetarët kryejnë punë vullnetare për të tjerët, por edhe për veten. Nuk ekziston asnjë përgjigje e vetme ose e thjeshtë për pyetjen se pse dikush kryen punë vullnetare.

Motivet të cilat i nxisin njerëzit të kryejnë punë vullnetare mund të jenë të ndryshme - dëshira për t'i ndihmuar personave në nevojë, nevoja për realizimin e vetes, nevojat për të qenë i dobishëm për bashkësinë, nevoja për njohjen e njerëzve të rinj, përfitimi i përvojës së punës, mundësia për mësimin e shkathtësive të reja, organizimi më i mirë i kohës së lirë, zgjidhja e dilemave ose problemeve, puna e përkohshme deri në gjetjen e ndonjë pune të paguar, etj.

Vini re! Çdonjëri kryen punë vullnetare për arsye personale, por duhet të ceket se të gjitha motivet e punës vullnetare duhet të vlerësohen njëjtë. Pa dallim të motiveve, të cilat mund të jenë "qartë bamirëse", ose ndonjë nevojë/ interes tjetër, puna vullnetare çdoherë e jep rezultatin e njëjtë - dobia për të tjerët dhe bashkësinë në tërësi.

*"Unë do ta kisha dhënë pa pagusë kohën time të lirë, për t'i ndihmuar dikujt tjetër. Pse jo? Secila punë, madje edhe puna vullnetare, sjell dobi të dyfishtë - për ne sjell njohuri të reja, profesionalizim të aftësive dhe shkathtësive dhe kënaqësi për ndihmën e dhënë, kurse tjetrit i siguron dobi nga puna e realizuar".
(Ana, 28 vjet)*



Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

NDARJA E PUNËS VULLNETARE

Puna vullnetare mund të ndahet sipas disa kriterëve: fusha e punës vullnetare (fusha dhe lloji i punës), kohëzgjatja e punës, niveli i veprimit, mënyra e organizimit të punës vullnetare, etj.

Sipas fushës së punës, puna vullnetare ndahet në:

- kujdesin për njerëzit e tjerë (për shembull, njerëzit e paaftë, të moshuarit, grupet e marginalizuara, fëmijët, të varfrit, etj).
- puna humanitare (për shembull, ndihma në rastet e fatkeqësive natyrore, si tërmetet, vërshimet ose ndihma në rajonet e kaluara nga lufta).
- puna sociale (për shembull, ndihma në institucionet shëndetësore ose sociale).
- mbrojtja e mjedisit jetësor (për shembull, aksionet e ndryshme ekologjike, ose me të cilat rritet vetëdija ekologjike)
- puna në fushën e kulturës (për shembull, organizimi i ngjarjeve kulturore, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, etj).

Sipas kohëzgjatjes, ekzistojnë modele të ndryshme të punës vullnetare, varësisht nga nevojat e punës konkrete dhe kohës të cilën mund ta ndajnë vullnetarët për punë vullnetare.

Shoqërohu me të tjerët me ide të ngjashme për përmirësimin e kushteve tuaja, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve për jetesë shoqërore.

Ndarja më e shpeshtë është puna vullnetare afatshkurtre dhe afatgjate.

Puna vullnetare *afatgjate* - zgjat disa muaj ose më tepër, dhe kërkon punë të vazhdueshme.

Puna vullnetare *afatshkurtre* - mund të jetë gjatë kohëzgjatjes së ndonjë aksioni, manifestimi ose ngjarje.

Sipas nivelit, mund të veprohet në nivel lokal, rajonal, nacional ose ndërkombëtar.

Puna vullnetare *lokale* është "puna në oborrin tuaj". Më së shpeshti kjo është edhe forma më e dukshme e punës vullnetare, për shkak se vullnetarët e njohin rajonin dhe esencën e punës. Së këndejmi, çdo ndryshim pozitiv vërehet shpejtë, dhe kjo e rrit motivimin.

Puna vullnetare në *nivel rajonal* zakonisht lidhet me veprimin drejt ndonjë problemi të caktuar në rajonin e dhënë, për shembull problemet e lidhura me Liqenin e Ohrit (duke e përfshirë edhe bashkëpunimin tejkuftar).

Puna vullnetare *nacionale* e nënkupton punën në nivel të shtetit, drejt zgjidhjes së ndonjë problemi. Në nivel *ndërkombëtar*, njerëzit e shteteve të ndryshme punojnë në zgjidhjen e problemeve. Për punën vullnetare ndërkombëtare ekzistojnë shumë programe për këmbim, ose përfshirje të vullnetarëve nga vendet e ndryshme.

Mund të japësh kontribut në krijimin e vizionit të posaçëm për botën dhe mjedisin mëthues.

Sipas mënyrës së organizimit të punës vullnetare, dallohet puna vullnetare joformale dhe formale.

Puna vullnetare **joformale** e nënkupton secilin lloj të ndihmës e cila jepet vullnetarisht, por nuk realizohet në kornizat e ndonjë organizate ose institucioni.

Puna vullnetare **formale** ka strukturë të caktuar, dhe realizohet në ndonjë organizatë ose institucion.

"Dhurata më e madhe të cilën e kam fituar nga puna vullnetare është privilegji i njohjes së nevojës, vullneti dhe dëshira për realizimin e këtyre nevojave, në një shtet ku shumë gjëra realizohen vështirë".
(deklaratë e një vullnetari)

"Mendoj që puna vullnetare e nënkupton lirinë e kryerjes së punëve sipas dëshirës dhe ideve personale".
(Lidija, 21 vjet)

Puna vullnetare është këmbim i anëve të mira të njeriut, para se të gjithash: mirësjellja, kuptimi, respekti, kujdesi dhe durimi.

ME PUNËN VULLNETARE MUND TË ARRISH :

Zhvillim personal

- mësimi i njohurive të reja, aftësive dhe shkathtësive;
- zbulimi dhe/ ose zhvillimi i potencialeve personale;
- kënaqësia nga puna dhe vetja për punën e kryer;
- ndjenja e të qenit të dobishëm dhe nevojshëm - ndjenja dhe gëzimi i veçantë;
- zhvillimi i vlerave personale;
- marrja e përvojës së punës dhe kualifikimit profesional;
- pasurimi i përvojës jetësore
- vetë-pjekuria;
- vetëbesimi;
- zgjidhja e disa dilemave dhe vështirësive;
- etj.



Zhvilloje përgjegjësinë tënde shoqërore.

Zgjidhja e problemeve konkrete

Puna vullnetare, përmes aksioneve lokale ose globale ndihmon në zgjidhjen e problemeve konkrete në shoqëri ose bashkësi. Kjo mund të jetë ndihmë konkrete dhe e njehershme e ndonjë rajoni të goditur nga ndonjë fatkeqësi natyrore (për shembull, pas tërmetit në Shkup në vitin 1963, është kryer shumë punë vullnetare nga vullnetarë të RSFJ-së, por edhe vendeve tjera të botës), ose punë e vazhdueshme si puna vullnetare në SOS linjë telefonike.

Qëllimi kryesor i secilit aktivitet vullnetar është arritja e përmirësimeve të dukshme, me të cilat kontribuohet në mirëqenien e përgjithshme të bashkësisë, në fushën e veprimit.

Zhvillimi i shoqërisë demokratike

Puna vullnetare në nivel më të gjerë shoqëror e përforcon drejtpërdrejtë shoqërinë qytetare dhe vlerat e saj. Puna vullnetare kontribuon në zhvillimin e ndërmarrjes së nismave nga njerëzit, i inkurajon aksionet e përbashkëta, dhe i motivon njerëzit të veprojnë për përmirësimin e gjendjes.

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E VULLNETARËVE

Puna vullnetare me vete sjell edhe disa të drejta dhe përgjegjësi të caktuara. Më së shpeshti, të drejta dhe përgjegjësitë e përgjithshme të vullnetarëve caktohen përmes ligjeve të posaçme për punën vullnetare në vend, dhe përveç kësaj, ato përcaktohen plotësisht nga secila organizatë / institucion për vete.

Në vijim jepen disa të drejta themelore të vullnetarëve, ose

Si vullnetar/e keni të drejtë:

- të dini se çka pritet nga ju;
- t'i merrni të gjitha informatat për punë në kohën e duhur;
- të punoni punë e cila nuk është e pakuptimtë;
- puna e juaj të vlerësohet njëjtë si edhe puna e personave të paguar;
- të keni mbikëqyrje dhe përkrahje;
- të dini kujt duhet t'i drejtoheni në rast se paraqitet ndonjë problem;
- të mos jeni të diskriminuar në asnjë bazë;
- të gaboni dhe të mësoni prej gabimeve;
- të keni kushte të sigurta për punë;
- të jeni të siguar, në rast se kushtet e punës e kërkojnë këtë;
- të tërhiqeni nga puna vullnetare, duke lejuar kohë për gjetje të zëvendësimit;
- të merrni vërtetim për kohën, vendin dhe detyrat e realizuara gjatë punës vullnetare;
- të keni mundësi ta shprehni mendimin tuaj për mënyrën e realizimit të detyrave të besuara;
- t'i dini të drejtat dhe obligimet tuaja.

Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

Disa prej përgjegjësiave themelore të vullnetarëve:

- respektimi i rregullave, vlerave dhe qëllimeve të organizatës në të cilën kryhet puna vullnetare;
- kryerja e punës në mënyrë të përgjegjshme;
- kryerja e projekteve dhe detyrave të dakorduara;
- saktësia;
- paralajmërimi i mungesës;
- respektimi i të tjerëve dhe të drejtave të tyre;
- respektimi i privatësisë dhe mirëbesueshmërisë së informatave me të cilat punoni;
- pjesëmarrja në edukimet dhe aktivitetet tjera që janë pjesë e punës;
- pranimi dhe dhënia e kritikave konstruktive;



Shoqërohu me të tjerët me ide të ngjashme për përmirësimin e kushteve tuaja, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve për jetesë shoqërore.

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ORGANIZATËS/ INSTITUCIONIT I CILI I ANGAZHON VULLNETARËT

Disa prej të drejtave të organizatës e cila i angazhon vullnetarët:

- lidhja e kontratës me vullnetarin/en;
- kërkesa për realizimin e detyrave në mënyrë të caktuar;
- përgatitja e planit për realizimin e detyrave;
- vendosja e standardeve për punë;
- kërkimi i cilësive dhe shkathtësive të caktuara nga vullnetarët/et;
- refuzimi i vullnetarëve të cilët nuk i përshtaten punës;
- kërkimi i përgjegjësisë dhe saktësisë;
- pranimi i tërheqjes nga puna vullnetare, në qoftë se vullnetari/ja nuk është i/e kënaqur nga puna;
- lutja e vullnetarëve për ndërprerje të punës në rast se nuk i respektojnë ose plotësojnë rregullat e dakorduara.

Disa prej obligimeve të organizatës e cila i angazhon vullnetarët:

- përcaktimi i qartë i detyrave të punës së vullnetarëve;
- vullnetarëve duhet t'i mundësohet njohja me punën;
- respektimi dhe vlerësimi i vullnetarëve;
- sigurimi i shpenzimeve të udhëtimit dhe kompensimit në të holla, sipas marrëveshjes së arritur;
- mundësimi i mjedisit të sigurt të punës;
- sigurimi i vullnetarëve, sipas marrëveshjes së arritur;
- mundësimi i përkrahjes, këshillimit, marrjes së informatave, mbikëqyrjes;
- sipas nevojës, modifikimi i detyrave në pajtim me mundësitë, aftësitë dhe parapëlqimet e vullnetarëve;
- mundësimi i zgjedhjes funksionale të vullnetarëve, dhe përfshirja e tyre në organizatë;
- mundësimi i edukimit dhe përkryerjes profesionale;
- mbajtja e komunikimit të rregullt me vullnetarët;
- përkujtimi i vazhdueshëm i rëndësisë së punës vullnetare.

Mund të japësh kontribut në krijimin e vizionit të posaçëm për botën dhe mjedisin mëthuës.

KU MUND TË REALIZOHET PUNA VULLNETARE?

Puna vullnetare është e dobishme në fusha të ndryshme, dhe pothuajse nuk është aspak e kufizuar në aspekt të fushëveprimit - përfshin punë nga puna administrative, deri tek këshillimi, puna në terren dhe puna fizike. Ekzistojnë shumë njerëz, vende dhe organizata të cilat kanë nevojë për vullnetarë, dhe vendi më i mirë për të marrë informata është ndonjë organizatë e cila merret me punë vullnetare.

Në Maqedoni deri tani nuk ekziston asnjë organizatë e pavarur vullnetare, por në organizata të ndryshme të sektorit civil ekzistojnë qendra për vullnetarë, të cilat i ndërlidhin vullnetarët me organizatat, japin informata më të detajuara, dhe e promovojnë punën vullnetare.

Njerëzit në botë kryejnë punë të ndryshme vullnetare, në fusha të ndryshme: në sos-linja telefonike, në shtëpitë e bonjakëve, në spitale - duke u shoqëruar me fëmijët e sëmurë rëndë, në punën me personat HIV-pozitivë, në këshillimin e të rinjve për jetën seksuale, në punën me viktimat e dhunës në familje, të burgosurit, ekipet e ndryshme të shpëtimit, kurset kompjuterike, kurset për gjuhë të huaja, entet e personave të moshuar, shërbimet juridike, meremetimin dhe rregullimin e hapësirave publike, ndihmën në organizimin e manifestimeve kompjuterike, mbrojtjen dhe pastrimin e mjedisit jetësor, punën me grupet e marginalizuara, të varfrit dhe fëmijët, ndihma e shkollave, kopshteve dhe enteve tjera, etj.

Puna vullnetare është këmbim i anëve të mira të njeriut, para se të gjithash: mirësjellja, kuptimi, respekti, kujdesi dhe durimi.

Aktivitetet e lartpërmendura japin mundësi të shumta për punë vullnetare në shtetet me qendra të zhvilluara të vullnetarëve. Institucionet kompetente në shtetin tonë nuk janë çdoherë të gatshme t'i pranojnë personat e interesuar për punë vullnetare. Kryesisht, kjo nuk ndodh për shkak se nuk kanë nevojë ose dëshirë, por për shkak se nuk kanë sistem adekuat ku do të përfshihen vullnetarët në punë. Por, në rast se je i/e interesuar për punë të caktuar vullnetare në ndonjë institucion shtetëror, të inkurajojmë të kërkosësh mundësi për realizimin e dëshirë. Mënyra më e thjeshtë është kontaktimi i drejtpërdrejtë i institucionit. Mund të përfshihesh edhe në ndonjë grup të vogël lokal i cili punon në zgjidhjen e ndonjë problemi, në ndonjë organizatë të madhe nacionale e cila dëshiron t'i ndihmojë grupeve të caktuara, ose mund t'i bashkëngjitesh ndonjë organizatë ndërkombëtare e cila punon në zgjidhjen e ndonjë problemi të madh global.

Para se të paraqitesh në ndonjë organizatë/ institucion, mendo për gjërat në vijim, të cilat mund të të ndihmojnë në zgjedhjen më adekuate të punës vullnetare:

- mendo për kohën tënde të lirë të cilën mund ta përkushtosh në punën vullnetare;
- mendo a dëshiron të paraqitesh vetëm ose me persona të tjerë;
- mendo ku dëshiron ta kryesh punën vullnetare - më afër vendit të banimit, ose je i/e gatshëm/me për udhëtime;
- mendo a ka diçka konkrete të cilën ke dëshirë ta bësh, si për shembull:

Zhvilloje përgjegjësinë tënde shoqërore.

...të ndihmohesh në përmirësimin e mjedisit ku banon;
...të njoftosh njerëz të ri;
...të bësh diçka të re;
...të bësh diçka të dobishme;
...ta shfrytëzosh kohën e lirë;
...ta shohësh mënyrën e jetesës së njerëzve tjerë;
...t'i zhvillosh interesat ose hobin personal;
...të bësh diçka për të cilën ke prije.



"Punën vullnetare e kryej për tetë vite me rradhë, përmes kësaj kam krijuar kontakte me shumë gjëra të cilat më interesojnë - kam mësuar njohuri të ndryshme, aftësi dhe shkathtësi prej të cilave kam dobi në jetën profesionale dhe personale".
(Lika, 29 vjet)

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.

Regjistri i organizatave qytetare të cilat angazhojnë vullnetar(ë)ë
Të dhënat për organizatat qytetare të cilat kryejnë aktivitete programore me punë vullnetare mund të gjenden në internet faqen e Platformës qytetare të Maqedonisë www.gpm.net.mk

Adresat ndërkombëtare

www.worldvolunteerweb.org - World Volunteer Web

www.csv.org.uk - CSV - Community Service Volunteers

www.crossculturalsolutions.org - Cross-Cultural Solutions

www.volunteermatch.org - Volunteer Match

www.sdint.org - Service Civil International

www.yap.org - Youth Action for Peace

www.onlinevolunteering.org - Online Volunteering Service

www.unv.org - UN Volunteers

www.vso.org.uk - Voluntary Service Overseas

www.peacecorps.gov - Peace Corps

<http://www.volunteerabroad.com> - Volunteer Abroad

Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

Disa fakte dhe të dhëna interesante për punën vullnetare:

- 5 dhjetori është dita ndërkombëtare e vullnetarëve për zhvillim ekonomik dhe social;
 - Viti 2001 ka qenë viti ndërkombëtar i vullnetarëve;
 - Organizata ombrellë e të gjitha organizatave vullnetare është *Co-ordinating committee of international voluntary service CCIVS*, e themeluar në vitin 1948 nga UNESCO;
 - Në aksionin për çrrënjosjen e paralizës fëmijërore në vitin 2000 kanë marrë pjesë mbi 10 milionë vullnetarë - gjithsej 550 milionë fëmijë kanë marrë imunitet në këtë aksion. Puna e tyre vullnetare vlerësohet në shumën prej 10 miliardëve dollarëve;
 - Australia jep viza për punë vullnetare për të rinjtë në moshën 18-30 vjeçare, pa dallim nga shteti i origjinës dhe lloji i punës - duke filluar nga ndihma në fusha, deri tek punët administrative. Ushqimi dhe vendosja sigurohen nga punëdhënësi, punohet nga 38 orë në javë, prej të hënës deri të premtën. Në disa raste, puna vullnetare mund edhe të paguhet;
 - 59% e adoleshenteve në SHBA kryejnë punë vullnetare, mesatarisht nga 3,30 orë në javë. Kjo e jep shifrën totale prej 13,3 milionë vullnetarëve, 2,4 miliardë orëve të punës dhe vlerës së plotë prej 7,7 miliardë dollarëve amerikanë;
 - Nga aspekti statistikor, në botë kryhet më tepër punë vullnetare në qytetet dhe mjediset e vogla, se sa në qytetet e mëdha;
- Shoqërohu me të tjerët me ide të ngjashme për përmirësimin e kushteve tuaja, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve për jetesë shoqërore.



- Të rinjtë më së shumti dëshirojnë të jenë aktivë në aktivitetet sportive, personat e moshës 35-44 vjeçare preferojnë aktivitete arsimore, 45-54 për mirëqenie shoqërore, kurse personat mbi moshën 55-vjeçare për aktivitete të ndryshme të hobit, besimit fetar dhe artit;

- Të rinjtë e moshës 16-24 vjeçare më tepër preferojnë të përfshihen në punën vullnetare joformale, se sa në punën formale;

- Femrat kryejnë tre herë më tepër punë vullnetare se meshkujt, por sipas orëve të punës, dy gjinitë kryejnë punë njëjtë.



Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

Deklaratë universale

E miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara

Puna vullnetare është një prej shtyllave themelore të shoqërisë qytetare që i ringjall synimet më fisnike të njeriut - angazhimin për paqe, liri, mundësi të barabarta, siguri dhe drejtësi për të gjithë njerëzit.



Ne këtë kohë të globalizimit dhe ndryshimeve të përhershme bota bëhet gjithnjë më shumë e vogël dhe më e ndërlikuar. Ngjarjet në të, gjithnjë e më shumë janë të varura njëra prej tjetrës dhe më komplekse. Puna vullnetare e më shumë veprimtaritë e individëve apo grupeve japin:

- mundësi për arritjen dhe përfundimin e vlerave njerëzore si bashkësia, kujdesi dhe ndihma
- individit si anëtar i bashkësisë, i cili tërë jetën ka mësuar, dhe është rritur, i jep mundësi për arritjen e të drejtave të tij dhe përgjegjësi dhe realizim të të gjitha potencialeve njerëzore të tij.
- mundësi për tejkalimin e ndryshimeve të cilat na ndajnë nga të jetuarit së bashku, në bashkësi të shëndosha dhe të qëndrueshme, së bashku të punojmë dhe të kërkojmë zgjidhje për të gjitha problemet e përbashkëta.



Në agimin e mijëvjeçarit të ri puna vullnetare është element i rëndësishëm për çdo shoqëri. Deklarata e Kombeve të Bashkuara thekson se "ne njerëzit" kemi fuqi ta ndryshojmë botën përmes ndërrimit të veprimeve dhe efektet praktike të tyre.

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.

Kjo deklaratë e mbështet të drejtën e të gjitha grave, burrave dhe fëmijëve që lirisht të bashkohen për punë vullnetare, pa marrë parasysh përkatësinë etnike, fetare, gjinore, gjendjen shëndetësore ose gjendjen shoqërore dhe ekonomike. Te gjithë njerëzit në botë duhet të kenë të drejtë që lirisht të ofrojnë kohën e tyre të lirë, talentin ose energjinë e tyre individëve të tjerë ose grupeve për veprimtari të veçantë, në mënyrë individuale ose me grupe, pa pritur shpërblim në të holla.

Përpiqemi të zhvillojmë punë vullnetare, e cila:

- do të shpinte drejt bashkëpunimit të të gjithë grupit, vullnetarët do t'i njohin vështirësitë dhe do të fillojnë me zgjidhjen e tyre
- ia huazon zërin atyre që nuk mund të flasin për vete
- të tjerëve i mundëson inkuadrim në punë vullnetare
- e plotëson, por nuk e kompenson veprimtarinë përgjegjëse të sektorëve të tjerë dhe punën e punëtorëve të paguar
- i mundësojmë njerëzve arritjen të njohurive të reja, aftësi dhe zhvillim më të mirë të potencialeve të tyre, vetëbesim dhe krijimtari.
- e mbështet solidaritetin brenda familjes, bashkësisë, shtetit dhe botës.

Zhvilloje përgjegjësinë tënde shoqërore

Përgjegjësia e vullnetarëve, organizatës dhe grupit përmes të cilëve vepron, sipas mendimit tonë është:

1. Krijimi i mjedisit ku vullnetarët me punën e tyre domethënëse kontribuojnë për arritjen e qëllimeve të caktuara.
2. Caktimi i kriterëve për pjesëmarrjen e vullnetarëve, duke i përfshirë edhe kushtet me të cilët obligimet e organizatës dhe vullnetarit mund të ndërpriten, dhe për hartimin e politikës për udhëheqjen e veprimtarive vullnetare.
3. Sigurimi i mbrojtjes adekuate të vullnetarëve dhe për ata të cilëve u ndihmojnë.
4. Ofrimi i aftësimit adekuat, vlerësimit të rregullt të punës dhe pranimit të meritave të vullnetarëve.
5. Sigurimi i qasjes dhe mundësive për bashkëpunim të të gjithëve, përmes mënjanimit të kufizimeve fizike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Duke i respektuar të drejtat themelore të njeriut, siç janë theksuar në Deklaratën për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara, parimet e punës vullnetare dhe përgjegjësisë të vullnetarëve dhe organizatave me të cilat janë të lidhura, bëjmë thirrje:

Dëshira dhe gatishmëria për ndryshimin e gjendjeve të caktuara.

TË GJITHË VULLNETARËT ta shprehin besimin e tyre në punën vullnetare si forcë ndërmjetësues kreative, e cila:

- krijon bashkësi të shëndosha dhe të qëndrueshme, që e respektojnë dinjitetin e të gjithë njerëzve
- i inkurajon njerëzit t'i fitojnë të drejtat e tyre të cilat i kanë si qenie njerëzore dhe në këtë mënyrë ta përmirësojnë jetën
- ndihmon në zgjidhjen e problemeve sociale, kulturore dhe ekonomike, dhe problemeve të mjedisit natyror, dhe
- ndërton shoqëri të drejtë dhe humane përmes bashkëpunimit global.

Udhëheqësit e:

- **të gjitha** sektoreve duhet të bashkohen në “qendra vullnetare” të fuqishme, të dukshme dhe efektive, në nivel lokal dhe shtetëror, si organizata themelore për punë vullnetare
- **qeverive** duhet t'i mundësojnë të gjithë njerëzve të drejta për punë vullnetare, t'i mënjanojnë të gjitha pengesat juridike për bashkëpunim, t'i përfshijnë vullnetarët në punën e tyre, dhe të gjejnë mjete për organizatat joqeveritare për promovimin dhe përrahjen e mobilizimit efektiv dhe udhëheqjes së vullnetarëve
- **ndërmarrjeve** duhet t'i inkurajojnë punëtorët e tyre që të kryejnë punë vullnetare në bashkësitë e tyre, dhe me fuqi njerëzore dhe mjete financiare ta përkrahin zhvillimin e punës vullnetare

Shfrytëzoi njohuritë dhe aftësitë për mirëqenien e njeriut dhe bashkësisë.

- **mediave** duhet të informojnë për punën vullnetare dhe duhet të publikojnë informata të cilat do t'i ndihmojnë dhe inkurajojnë njerëzit për punë vullnetare

- **arsimit** duhet t'i inkurajojnë njerëzit e të gjitha moshave për punë vullnetare, përmes krijimit të mundësive për mësim nga kryerja e punës vullnetare

- **institucioneve fetare** duhet ta paraqesin punën vullnetare si jehonë adekuate e nevojës shpirtërore të secilit për të ndihmuar

- **organizatave joqeveritare** duhet tu krijojnë vullnetarëve kushte të volitshme, dhe me forca njerëzore dhe mjete financiare të kontribuojnë për kyçjen e tyre efektive.

Kombet e Bashkuara duhet ta shpallin këtë dhjetëvjetor për "Dhjetëvjetor të punës vullnetare dhe shoqërisë qytetare" dhe me këtë ta njohin "V e kuqe" si shenjë universale për punë vullnetare.



Shoqërohu me të tjerët me ide të ngjashme për përmirësimin e kushteve tuaja, mbrojtjen e mjedisit dhe krijimin e kushteve për jetesë shoqërore.

Lidhja ndërkombëtare për punë vullnetare (IAVE) i bën thirrje të gjithë vullnetarëve dhe udhëheqësve në të gjitha sferat në tërë botën që të bashkohen si partnerë për promovim dhe mbështetje të punës vullnetare efektive dhe të arritshme për secilin, që duhet të jenë simbol i solidaritetit i të gjithë njerëzve dhe popujve. Lidhja ndërkombëtare i bën thirrje të gjitha organizatave vullnetare në botë për hulumtim, komentim dhe realizim të Deklaratës universale, përmes punës së tyre.



Deklarata është miratuar nga Këshilli drejtues ndërkombëtar i Lidhjes ndërkombëtare për punë vullnetare (IAVE International Association for Volunteer Effort), në konferencën botërore të 16 me radhë për vullnetarë në Amsterdam, Holandë, në janar të vitit 2001 - viti ndërkombëtar i vullnetarëve të OKB-së.



Mund të japësh kontribut në krijimin e vizionit të posaçëm për botën dhe mjedisin rrethues

Titull:

Doracak për vullnetarë

Doracaku e përgatitën:

Ana, Milica, Aleksandar, Gordana, Jovan, Sashka, Dragi, Tanja, Lidija, Ivana, Aleksandra, Frosina

Botues:

Ambasada e parë e fëmijëve në botë - Megjashi, Republika e Maqedonisë

Drejtor ekzekutiv:

Dragi Zmijanac

Përktheu në shqip:

Fatbardha Shehu

Adresa e botuesit:

Ambasada e parë e fëmijëve në botë - Megjashi, Republika e Maqedonisë
rrugë Kosta Novakoviç n. 22 a,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

e-mail: first@childrensembassy.org.mk


info@childrensembassy.org.mk

www.childrensembassy.org.mk

Shtypur në shtypshkronjën:

Jugoreklam

Puna vullnetare është këmbim i anëve të mira të njeriut, para se të gjithash: mirësjellja, kuptimi, respekti, kujdesi dhe durimi



CIP - Каталогizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Sv. Kliment Ohridski"
Skopje

316.354-056.87(036)

DORACAK për vullnetarë / [doracaku e përgatitën Ana, ... [и др.] ; përktheu ne shqip Fatbardha Shehu]. - Skopje : Ambasada e parë e fëmijëve në botë - Megjashi, 2007. - [32] стр. : илустр. во боја ; 10x15 см

ISBN 978-9989-2356-1-0

a) Волонтерство - Водичи
COBISS.MK-ID 69792778

